# DËSHMI ARKIVI

**A-438220**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | BE reagon para vendimit për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-së: Respektoni verdiktin e Speciales, nuk është përfundimtar |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/rajoni/be-reagon-para-vendimit-per-thacin-dhe-ish-kreret-e-uk-se-respektoni-verd-i585588` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 11:21:18 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 12:30:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `eaa974104179d2c2a57f12ed1bfdf000333e9ba135f2c35b1ac8bf41727a75fb` |
| TEKSTI | `8a849d0fc6e9d801b8546496b0f7e3a4ba19c0c5a7f615ca97ac293d49d058a0` |
| PAMJA | `cff44e029fb0a58dc6008a962f423fb96403fc4bd85efd1536ce6bb4d4c7678f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c765ec83f915f546a6b63c8a93ab28eec1cec109835b76be988604a2bcabed61` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c765ec83f915f546a6b63c8a93ab28eec1cec109835b76be988604a2bcabed61`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# BE reagon para vendimit për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-së: Respektoni verdiktin e Speciales, nuk është përfundimtar

12 Shtator 2026, 14:30Rajoni TEMA

BE reagon para vendimit për Thaçin dhe ish-krerët e

Bashkimi Europian ka reaguar në lidhje me zhvillimet e fundit dhe vendimin që do të jepet pas 4 ditësh për Hashim Thaçin dhe ish-krerët e tjerë të UÇK në Dhomat e Specializuara në Hagë.

Në një reagim për Gazeta Express, BE ka kërkuar që shtetet e përfshira dhe palët në çështje të tregohen të përmbajtur dhe të respektojnë vendimin e gjykatës. Bashkimi Europian ka kërkuar respektimin e vendimit që do të merret ndaj katër të akuzuarve në Hagë, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi.

“Në prag të shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë në çështjen e Prokurorit të Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, u bëjmë thirrje të gjitha shteteve dhe palëve që të respektojnë procedurat gjyqësore të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe vendimin”, thonë nga Brukseli.

BE potencoi mbështetjen e kahershme të saj për Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) si “një institucion gjyqësor i pavarur”, ndërsa rikujtoi se është “themeluar me vendime të Kuvendit të Kosovës në vitet 2014–2015”.

“Parlamenti i Kosovës (përmes një amendamenti kushtetues) autorizoi zhvendosjen e procedurave në Hagë, për të ndihmuar në garantimin e procedurave gjyqësore të pavarura, të paanshme dhe të drejta në lidhje me pretendimet për krime të rënda të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë”.

Por, BE-ja vë në pah se vendimi i 16 shtatorit nuk është fundi i procesit gjyqësor dhe se ai mund të apelohet nga të dyja palët.

“Ashtu si në të gjitha procedurat e tjera gjyqësore, ndaj aktgjykimeve të shkallës së parë mund të ushtrohet ankesë si nga mbrojtja, ashtu edhe nga prokuroria”.

Në fund, Bashkimi Europian thotë se “puna e Dhomave të Specializuara të Kosovës është e rëndësishme për promovimin e llogaridhënies dhe njohjen e përvojave të viktimave dhe familjeve të tyre nga të gjitha komunitetet e Kosovës”.

Në mbrojtje të katër ish-krerëve të UÇK-së në Prishtinë sot do të nisë një marsh paqësor nga ora 14:00 ku pritet të vijnë qytetarë nga e gjithë Kosova. Kërkesa e tyre është drejtësia për Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin.

Ndërkohë, i gjithë procesi gjyqësor në Hagë është përcjellë me kritika nga Kosova për punën e Gjykatës Speciale, duke e quajtur atë si të njëanshme.

Aktakuza e Prokurorit të Specializuar përmban 10 pika ndaj katërshes, gjashtë prej të cilave janë për krime kundër njerëzimit dhe katër për krime lufte. Në fillim të këtij viti ZPS kishte kërkuar nga 45 vjet burgim për të akuzuarit.

Specialja është formuar në vitin 2015, ndërsa nisi të operojë në 2016-2017 pas shkëmbimeve të letrave Kosovë-BE, ndryshimeve kushtetuese dhe marrëveshjes me Holandën për zhvendosjen e Dhomave të Specializuara atje.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Qytetarë nga Shqipëria dhe diaspora drejt Prishtinës, nisen për marshin në mbështetje të ish-drejtuesve të UÇK-së (VIDEO)

12:38 Rajoni

Si skenë filmi/ I burgosuri shqiptar arratiset nga spitali në Greqi! Grupi i armatosur e me makina "policie" neutralizon eskortën e burgut

09:00 Rajoni / 3 komente

"Kosova po pret"/ Sot "Marshi për Liri" në Prishtinë për Thaçin, Veselin, Krasniqin dhe Selimin

08:00 Rajoni / 3 komente

Kosovë, Gjykata e Apelit liron nga akuzat Agim Çekun dhe 9 të dënuarit e tjerë në rastin "Veteranët"

21:44 Rajoni / 3 komente

Nga Kosova te Shqipëria, si do të ndryshonte politika gjermane në Ballkan me AfD-në në pushtet

20:10 Rajoni / 14 komente

Kosovë, tjetër dështim për konstituimin. Shtyhet seanca, nuk ka dakordësi për nënkryetarët

18:10 Rajoni / 3 komente

Dyshohet se mori 17.500 euro ryshfet, arrestohet ndihmësdrejtori i Doganave në Maqedoninë e Veriut

17:50 Rajoni / 5 komente

Rifillon seanca në Kuvendin e Kosovës, PDK vijon bojkotin pas rrëzimit të kandidaturës së Vlora Çitakut për nënkryetare të Kuvendit

15:17 Rajoni / 2 komente

VIDEO/ Dështon sërish seanca konstituive në Kosovë, deputetët largohen nga salla

12:45 Rajoni / 3 komente

I joshur nga Putini, Xi dhe Trumpi, "mjeshtri i manipulimit" përballet me provën e madhe: Vuçiç lë Presidencën dhe synon postin e kryeministrit

e kryeministrit

12:20 Rajoni / 1 koment

## Më të lexuarat

### 24 oret e fundit

### Javen e fundit

**PISA, hakmarrja europiane për mësueso-fobët shqiptarë**

16:18 Politika / 48 komente

**Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës investon 2 milionë euro ...**

13:45 Sociale / 3 komente

**"Në emrin tim flas vetëm unë"/ Rama për arrestimin e Agas...**

22:46 Politika / 28 komente

**Ullishtja kombëtare e pronësisë shqiptare**

17:00 Editorial / 20 komente

**"Për dosjet e qytetarëve vite pritje, për pagat e veta Gj...**

16:23 Politika / 51 komente

## Blog Tema

**John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?**

11:40 Blog

**Haga, midis maktheve dhe paranojave**

21:25 Blog / 2 komente

**Haga, midis maktheve dhe paranojave**

21:00 Blog / 1 koment

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by

- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.